



Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



02/ Nr. 4611  
Data: 27.06.2022

**PROCESVERBAL I DEBATIT PUBLIK  
NË LIDHJE ME KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE  
(KAB) 2023-2025**

Procesverbali nga Debatit Publik në lidhje me Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2023-2025, që u zhvillua me datën **24.06.2022** në tre lokacione: **Han të Elezit**, në **Gorancë** dhe në **Paldenicë**.

Debatet publike i kryesoi Kryetari i Komunës **z. Mehmet Ballazhi**.

Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2023-2025 e prezntoi Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, **znj.Lindita Ballazhi**.

**– Debati Publik në Han të Elezit**

Debati Publik në Han të Elezit filloi në orën 15:00 dhe u mbajt në Sallën e Takimeve në Katin e I-rë, te objekti i Komunës Hani i Elezit. Në këtë debat të pranishëm ishin 23 pjesëmarrës.

(Drejtoresha e DBF-së, Znj.Lindita Ballazhi prezntoi Kornizën Afatmesme Buxhetore 2023-2025)

**Mehmet Ballazhi:** Për projekt propozime për vitin buxhetor 2023 e hap diskutimin.

**Basri Maliqi:** Unë pash te lista e projekteve që në sektorin e bujqësisë nuk ka investime dhe duke e ditur që shumë nga ne merremi me bujqësi, do të ishte mirë që të investohet më shumë në bujqësi, qoftë edhe përmes donatorëve.

**Mevludin Kuka:** Te vendi i quajtur "Te Lloka", është një kanal me gjatësi diku 255 metra, dhe me u shtru me beton. Gjithashtu te vendi nën breg, është një rrugë që ka konteste fqinjësore, megjithatë kur është mbajtur takimi për zgjedhjen e Këshillit të Fshatrave, ku ka qenë edhe Drejtoresha e Administratës, banorët janë bërë bashkë dhe e kanë hap atë rrugë dhe besoj se krejt tash pajtohen që ajo rrugë me u shenjëzu, pra kish mjaftu që prej Komunës me u shtru me zhavor ose diçka e tillë, sa të dihet si rrugë.

**Visar Hasallari:** Unë ka disa vite që marr pjesë në debate të tilla dhe jam i kënaqur që shumë projekte po i shoh që janë të nevojshme dhe i kemi kërku si KVRL, si furnizimi me kioskë për

dokumente, psikolog për shkolla, etj, Megjithatë nuk po shoh rrugën Hasallar-Hunel, do të ishte e nevojshme shtrimi i kësaj pjese, poashtu vendi i pritjes te Lagjja e Re me u rregullu, shkollat të kenë ujë të pijshëm, shkolla e Seçishtës të inventarizohet, si dhe furnizimi i fshatrave me shporta për hudhjen e mbeturinave.

**Përparim Rexhallari:** Unë do të përqendrohem në shëndetësi, është e vështirë që me staf kaq të vogël të jetë funksional shërbimi 24/7, ku momentalisht jemi 32 të gjithë punëtorët, mjekë, infermierë e të tjerë dhe është më se i nevojshëm shtimi i stafit. Dhe poashtu do të ishte e nevojshme që të shtohet një aneks ose një objekt shtesë e QKMF-së sepse kërkesat e pacientëve janë të shumëta për ofrim të shërbimeve, kurse kapacitetet janë të pakta në krahasim me kërkesat. Gjithashtu, është nevoja e ofrimit të shërbimeve të stomatologjisë. Shqetësuese është demolimi që po ndodh në AMF-Gorancë nga persona të pandërgjegjshëm dhe si të nevojshme e shohim instalimin e kamerave të sigurisë.

**Hajrullah Kalisi:** Te Rr. “Veteranët e UÇK-së”, rruga është e drejtë për shumë metra dhe duhet intervenu me vendosjen e pengesave në rrugë, në mënyrë që vozitësit me e ulë shpejtësinë dhe të veprojnë para se të ndodhë ndonjë fatkeqësi.

**Mehmet Ballazhi:** A ka dikush edhe ndonjë projekt propozim tjetër? Nëse nuk ka, e shpall të mbyllur Debatin Publik.

Debati Publik në Han të Elezit përfundoi në orën 16:00.

### – **Debati Publik në Gorancë**

Debati Publik në Han të Elezit filloi në orën 17:00 dhe u mbajt në hollin e Sh.F.M.U. “Veli Ballazhi” në Gorancë. Në këtë debat të pranishëm ishin 27 pjesëmarrës.

(Drejtoresha e DBF-së, Znj.Lindita Ballazhi prezntoi Kornizën Afatmesme Buxhetore 2023-2025)

**Mehmet Ballazhi:** Për projekt propozime për vitin buxhetor 2023 e hap diskutimin.

**Selman Vila:** Tre janë problemet kryesore te ne: uji, kanalizimi dhe rryma. Është një kanalizim mbi 1000 metra dhe me u mundësu rregullimi i tij sepse ka afërsi me burimin, kurse problem është edhe rryma sepse mjafton diçka e vogël dhe ndalet rryma, dhe me mujt me u bo lidhja me xehroren.

**Shefket Lusnjani:** Qysh tha edhe Selmani, problemet kryesore janë uji, kanalizimi dhe rryma. Poashtu, propozoj ndërtimin e rrugës Gorancë-Krevenik dhe rruga për te pishat, kurse sa i përket ujit, kemi shumë probleme dhe ju falënderojmë për vendosjen e pompës së ujit, por urgjentisht duhen vendosur orëmatësit. Gjithashtu, me u vendos rrethoja te varrezat te Hunelët.

**Faruk Berisha:** Unë propozoj që të ketë më shumë për bujqësinë. Poashtu te shkolla ka nevojë me u vendos një mburojë dhe ndërtimi i një parkingu.Për ujin unë kam bisedu me plot njerëz, gjithashtu edhe me Bifurkacionin dhe ata kanë thënë që janë të gatshëm, vetëm se duhen vendosë orëmatësit, gjithashtu edhe për rrymën kam bisedu me KEDS dhe kemi bërë kërkesë te ata, që me

bashkëpunu dhe dikush me siguru betonimin apo vendosjen e trafos, dikush shtyllat, etj. Poashtu, pash që planifikohen 5000€ në AMF, dhe propozoj që të investohet në një hapësirë rekreative për fëmijët.

**Zenun Berisha:** Do të ishte mirë me u shtru rruga Gorancë-Krevenik dhe të ketë rekreacion te Pishat.

**Rashid Lusnjani:** Përveç tjerave që i përmendën, unë propozoj me u rregullu një stazë për pritje te varrezat.

Debati Publik në Han të Elezit përfundoi në orën 18:00.

### – Debati Publik në Paldenicë

Debati Publik në Paldenicë filloi në orën 18:30 dhe u mbajt në oborrin e Sh.F.M.U. “Kështjella e Diturisë” në Paldenicë. Në këtë debat të pranishëm ishin 7 pjesëmarrës.

(Drejtoresha e DBF-së, Znj.Lindita Ballazhi prezntoi Kornizën Afatmesme Buxhetore 2023-2025)

**Mehmet Ballazhi:** Për projekt propozime për vitin buxhetor 2023 e hap diskutimin.

**Ahmet Krasniqi:** Unë propozoj rregullimin e shtartit të proit të Lakit, kështu quhet. Poashtu lidhjen e sallës së sportit me objektin e shkollës. Rregullimi i rrugës prej Stanit në Vortomicë, sepse s’ka asfaltim.

**Suad Curri:** Si përfaqësues i fshatit Dërmjak, kam disa propozime: rregullimi i murit te Rr. “Adem Jashari”, rregullimi i rrugicës me kubëza, rregullimi i rrugës për në Skallavac, diku 780m e gjatë dhe afërsisht 4 m e gjërë, dhe ndriçimi i rrugëve. Dhe gjithashtu që të shtohen hapësirat te shkolla dhe të krijohet një lloj parku.

**Nesim Dernjani:** Për shkak të fëmijëve që shkojnë në shkollë, rryga nuk ka trotuar dhe ka rrezik për to, dhe duhet rregulluar trotuar për sigurinë e fëmijëve dhe të tjerëve.

**Rami Axhami:** Te rruga e Baki Vilës, para boshnjakëve, me u bo 4-5 metra. E poashtu edhe ky vendi këtu afër shkollës, mundet me u bo si një park ku kanë me pas ku me dal fëmijët po edhe të tjerët, sepse këtu mungojnë këto hapësira. Gjithashtu, do të ishte mirë që t’organizohen aksione të pastrimit herë pas here.

Debati Publik në Paldenicë përfundoi në orën 19:30.

Procesmbajtësja  
Liridona Ballazhi

